



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA “ALBPETROL” SH.A.

Nr. _____ Prot.

Patos, më __.01.2024

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT
(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)**

Data 11.01.2024

Nga: “Albpetrol” sha – Patos

Drejtuar: OE “ECCAT Environmental Consulting, Chemical Analysis & Testing” shpk me NUIS L51512009E, me adresë: Tiranë, Njësia Bashkiake Nr.5, Rruga “Irfan Tomini”, Pallati Nr.50, Kati I - rë.

Procedura e prokurimit/lotit: Procedurë e hapur me mjete elektronike

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-77341-08-11-2023

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Shërbim për monitorimin e mjedisit”

Kohëzgjatja e kontratës është 12 muaj nga data e lidhjes së kontratës.

Buletini i Njoftimeve Publike: Nr. 70 datë 21 Gusht 2023

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: Oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim.

Me anë të këtij njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik “ECCAT Environmental Consulting, Chemical Analysis & Testing” shpk me NUIS L51512009E, me vlerë oferte në total 7,811,869.74 lekë pa TVSH.
2. Operatori Ekonomik “QËNDRA E MONITORIMIT TË MJEDISIT” shpk me NUIS K92402036A, me vlerë oferte në total 11,779,092 lekë pa TVSH.
3. Operatori Ekonomik “TENUIS LABORATORIES” shpk me NUIS L81904506I, me vlerë oferte në total 10,189,500 lekë pa TVSH.

* * *

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

- Operatori ekonomik “QËNDRA E MONITORIMIT TË MJEDISIT” shpk për arsyet e mëposhtme:

- *OE në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, nuk ka deklaruar në deklaratën “B” “Për dorëzimin e ofertave të pavaruara” nëse ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi. Kjo në kundërshtim me kërkesat e pikës “gj” të pikës “I” “Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/ kualifikimit” , të shtojcës 8 të DST-së.*
- Operatori ekonomik “TENUIS LABORATORIES” shpk me NUIS L81904506I për arsyet e mëposhtme:
 - *OE në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, nuk ka deklaruar emrat e personit (personave) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, të cilët nuk janë ose nuk kanë qenë të dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së, konkretisht për ortakun P.M. (referuar ekstraktit historik të OE). Kjo në kundërshtim me kërkesat e gërmës “ç” të pikës “I” “Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/ kualifikimit” , të shtojcës 8 të DST-së.*
 - *OE në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, nuk ka deklaruar në deklaratën “A” “Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës” emrat e punonjësve të stafit teknik paralel me profesionin të cilit i përkasin. Kjo në kundërshtim me kërkesat e pikës 2.3.3. dhe 2.3.4 të pikës 2.3 “Kapaciteti teknik”, të shtojcës 8 të DST-së.*
 - *OE nuk ka paraqitur kopje të certifikuar të bilancit për vitet financiare 2020, 2021, 2022, të konfirmuar nga administrata tatimore. Kjo në kundërshtim me kërkesat e pikës 2.2.1. të pikës 2.2. “Kapaciteti ekonomik dhe financiar” të DST-së.*
 - *OE në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, nuk ka deklaruar në këtë shtojcë disponimin e një Laboratori të akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit sipas ISO 17025:2017, të pakten 1(nje), për monitorimin e cilesise se ajrit, ujit dhe monitorimin e zhurmave, sipas termave të referencës, **i cili të jete ne pronesi ose me qira**. Kjo në kundërshtim me kërkesat e pikës 2.3.9. të pikës 2.3 “Kapaciteti teknik”, të shtojcës 8 të DST-së.*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë OE, “ECCAT Environmental Consulting, Chemical Analysis & Testing” shpk me NUIS L51512009E, me adresë: Tiranë, Njësia Bashkiake Nr.5, Rruga “Irfan Tomini”, Pallati Nr.50, Kati I - rë, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 7,811,869.74 (shtatë milion e tetëqind e njëmbëdhjetë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e nëntë pikë shtatëdhjetë e katër) lekë pa TVSH, është identifikuar si Ofertë e suksesshme.

* * *

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Drejtorisë së Prokurimit Publik të “Albpetrol” sha, rruga Fier-Patos km 7, Fier, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzoni sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj, dhe tenderi do të anulohet, siç parashikohet në nenet 83 dhe 98 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

PO JO

Vendimet përfundimtarë të KPP-së: Nr. 1250/2023 datë 05.12.2023, Nr. 1365/2023 datë 27.12.2023 dhe 1370/2023 datë 27.12.2023.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Eltar DEDA